

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INDUSTRIE, NDERMARRËSISË DHE TREGTISË
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE

Nr./Br./No. 6111/19 Nr. i faq./Br. str./No. pg. _____
Data/Datum/Date 16.10.2023
PRISHTINE



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:204644

Datë: 25.09.2023

Numri i dokumentit: 04715559

Ka. nr. 286/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e Kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Subjekti ekonomik - Person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në lagjen “Arbana”, rruga “Ismajl Kryeziu”, pn, në Prizren, me pronar Shkelzen Jusaj, me NUI:810527195, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe 2 pika 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Ushtruesi i Kërkesës - MINT-së - Inspektorati i Tregut, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.186/04-2022, të datës 02.05.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 3, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 25.09.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si pjesërisht e bazuar ankesa e paraqitur nga Ushtruesi i Kërkesës - MINT-së - Inspektorati i Tregut, dhe

NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 186/04-2022, i datës 02.05.2023, vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik - Person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në lagjen “Arbana”, rruga “Ismajl Kryeziu”, pn, në Prizren, me pronar Shkelzen Jusaj, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe 2 pika 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, konform nenit 35 të LK-së, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej **1000(njëmijë)€**, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut, në Prishtinë, me numër të Ref. 19/2022 të datës 27.09.2022, dhe me numër të Protokollit 5839-19, me aktgjykim K.nr. 186/04-2022, të datës 02.05.2023, të pandehurën Subjektin ekonomik – si person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në lagjen “Arbanë”, rruga “Ismajl Kryeziu”, pn, në Prizren, e ka shpall përgjegjëse sepse:

-me datë 26.07.2022, gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të MINT-së, të Subjekti ekonomik - person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në lagjen “Arbana”, rruga “Ismajl Kryeziu”, pn, në Prizren, është konstatuar se ushtron veprimtarin ekonomike të shitjes me pakicë të dizellit dhe benzinës pa Licencë, me ç veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe 2 pika 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, **dhe i ka shqiptuar sanksionin kundërvajtës Qortim**, pasi që ekzistojnë rrethanat të cilat në masë të konsiderueshme e zvoglojnë përgjegjësinë e kryesit të kundërvajtjes, konform nenit 28 par. 2 të LK-së.

Kundër këtij aktgjykimit ka ushtruar ankesë Ushtruesi i Kërkesës - MINT-së - Inspektorati i Tregut, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së procedurës kundërvajtëse, në të cilën veç të tjerash thekson: Gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar sanksionin Qortim duke theksuar se ekzistojnë rrethanat të cilat në masë të konsiderueshme e zvoglojnë përgjegjësinë e kryesit të kundërvajtjes, duke shtuar se i njëjti e ka prezentuar licencën për shitjen me pakicë të NDN-së. Duhet pas parasysh gjykata se në momentin e inspektimit i njëjti ka operuar pa licencë për shitje me pakicë të NDN-së. Po ashtu gjykata me rastin e shqiptimit të qortimit nuk ka aplikuar të drejtën materiale, për shkak se për kundërvajtjen nga neni 6 par. 1 dhe 2 pika 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, parashihet dënimi me gjobë prej 5.000 -15.000€, për person juridik. Andaj, shqiptimi i Qortimit është plotësisht në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i ankimuar të Anulohet dhe çështjen ta kthen në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i kësaj Gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur, në bazë të deklaratës së Përfaqësuesit të së pandehurës sipas autorizimit Senat Elshani, Avokat nga Prishtina, të dhënë pranë Gjykatës së shkallës së parë, në Procesverbal të datës 07.12.2022, i cili ka deklaruar se nuk e ka të qartë çka po kërkon MINT-së, andaj kërkon ballafaqim me ushtruesin e kërkesës, kanë një Pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë dhe janë në pritje të marrjes së Licencës, në bazë të Procesverbalit mbi ballafaqimin e Përfaqësuesit sipas autorizimit Senat Elshani me Ushtruesin e kërkesës – Inspektoren Shkendije Bajrami, e cila ka deklaruar se kompania duhet me pas Licencë për me punuar por e njëjta nuk ka qenë e pajisur me licencë në kohën e inspektimit dhe pas 5 muajve është pajisur me licencë, Përfaqësuesit sipas autorizimit Senat Elshani, ka theksuar se kompania ka ushtruar kërkesë për tu pajisur me licencë dhe tani është pajisur me Licencë më datë 07.12.2022, andaj gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 36 të LK-së, është dashtë ta pezulloj procedurën për arsye të mënjanimi të gjendjes kundërligjore, në bazë të Procesverbalit të Inspektimit Nr. 00455/22 të datës 25.07.2022, Licencës për Biznes në

Sektorin e Naftës për shitje me pakicë të NDN-së, me afate të vlefshmërisë së Licencës prej 07.12.2022 deri më 06.12.2028, Pëlqimit të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent Nr. 1958/22, të datës 11.11.2022, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprë kundërvajtëse nga neni 6 par. 1 dhe 2 pika 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, andaj për këtë kundërvajtje mban përgjegjësi.

Kolegji vendosi që ta NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur, sa i përket sanksionit kundërvajtës duke pas parasysh se në kohën e inspektimit nuk ka qenë i pajisur me Licencë për shitje me pakicë të NDN-së, ashtu si që kërkohet sipas ligjit, andaj ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik - Person juridik "Petroll Company" SH.P.K, Njësia në lagjen "Arbana", rruga "Ismajl Kryeziu", pn, në Prizren, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe 2 pika 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, konform nenit 35 të LK-së, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej **1000(njëmijë)€**, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse, të tilla apo të ngjashme.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka. nr. 286/2023, me datë 25.09.2023



KRYETARIA KOLEGJIT,
Azra Cakolli